



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**ZL.Anr.776/2017**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Ymer Hoxha dhe Gyltene Sylejmani anëtar, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Shkendije Zenelaj kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Suharekë nga subjekti politik Nisma për Kosovën, dega në Suharekë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtar të Kuvendit Komunal, të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 12.11.2017, mori këtë:

## **V E N D I M**

- I. PRANOHET** si i bazuar apeli i Shkendije Zenelaj kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Suharekë nga subjekti politik Nisma për Kosovën, dega në Suharekë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtare të Kuvendit Komunalë, të mbajtura më datë 22.10.2017.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj të gjitha fletëvotimet e kandidates Shkendije Zenelaj nga subjekti politik Nisma për Kosovën, në Vendvotimet: 2423A/01R, 2411A/01D dhe 2416A/01D.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 09.11.2017 ka pranuar një apel nga Shkendije Zenelaj kandidate për anëtare për Kuvendin Komunal në Suharekë nga subjekti politik Nisma për Kosovën, dega në Suharekë, me të cilin ka theksuar se në vendvotimin 2423A/01R fshati Sllapuzhan ditën e zgjedhjeve drejtpërdrejt nga qendra e votimit janë raportuar me telefon se janë 8 vota, ndërsa në procesverbalet e komisionarëve figurojnë 5 vota. Më tej ka shtuar se në vendvotimin

2411A/01D fshati Mohlan, nga raporti i vëzhguesit ka 14 vota, ndërsa në procesverbal nga komisionarët e KQZ-së ka 13 vota. Po ashtu parashtruesja e ankesës ka theksuar se në vendvotimin 2416A/01D, kanë votuar dy familjarë të saj ndërsa në raport nga komisionarët janë zero (0) vota.

Parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një CD dhe raportin e votave për kandidatët për Kuvendin Komunal nga Vëzhguesit.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoi pretendimet ankimore dhe shkresat e tjera si dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

### **Apeli është i bazuar**

Paneli gjeti se pretendimet ankimore janë të bazuara, pasi që pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës, shihet qartë se parashtrueses së ankesës i janë shënuar më pak vota nga sa realisht janë raportuar ditën e Zgjedhjeve e cila gjë vërtetohet edhe nga CD- e ofruar si dëshmi. Andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidaten e subjektit politik Nisma për Kosovën Shkendije Zenelaj, në vendvotimet 2423A/01R, 2411A/01D dhe 2416A/01D, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

ZL.A.nr. 776/2017 me datën 12.11.2017



**Këshillë Juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.